

ALARM 18

DE-SPINIMI I NJË SPINI

NJË PREJ MËNYRAVE MË EFIKASE PËR DE-SPINIM ËSHTË ANALIZA PËRKATËSE E LAJMIT TË SPINUAR, IDENTIFIKIMI I MANGËSIVE (KEQINFORMIMET E INTEGRUARA MADJE EDHE GËNJESHTRAT E DUKSHME) DHE PREZANTIMI JO VETËM I SË VËRTETËS, POR EDHE I SHKELJES EVENTUALE TË SË DREJTËS QË BËHET ME DHE NËPËRMJET SPINIT.

Shkruan: prof. D-r Mirjana Najçevska, ekspert për të drejtat e njeriut

Spini është pjesë e propagandës dhe paraqet vegël të preferuar të politikanëve (veçanërisht atyre që vetëm më gjenden në pushtet): Në çastin kur një numër i madh i medie në një shtet janë të vendosur në një rol të varur ose në lidhje tejet të afërt me strukturën në pushtet, spini paraqet vegël bazë për veprim politik. Në situata kur spini bëhet vegël e rregullt e veprimit politik dhe betejës politike, bëhet e domosdoshme zhvillimi i metodave për de-spinim, me qëllim që të shmanget rreziku që gënjeshtër të përsëritur mijë herë të bëhet „e vërtet“.

Jo secili spin duhet de-spinuar. Gjegjesisht, ka spine të parëndësishme që nuk kanë ndikim thelbësor mbi mendimin publik. Por, ka spine që paraqesin pjesë të kampanjës më të gjerë mediatike dhe që krijojnë qëndrim të gabuar tek më shumë persona. Këto spine duhet de-spinuar nga mediat që do të identifikojnë spinin.

Një prej mënyrave më efikase për de-spinim është analiza e përshtatshme e lajmit të spinuar, identifikimi i mangësive (keqinformimet e integruara madje edhe gënjeshtër e dukshme) dhe prezantimi jo vetëm i së vërtetës, por edhe i shkeljes eventuale të së drejtës që bëhet me dhe nëpërmjet spinit.

Vetëm si shembull do të marrim **spinin për shpenzimin e mjeteve financiare të Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni**¹, që para do kohe u paraqit në më shumë medie, por nuk oshte, ose nuk ishte de-spinuar siç duhet (një prej mënyrave të pakta për të de-spinuar, madje edhe si pjesë e një analize më të gjerë, u bë nga **artikulli i Utrinski Vesnik**², pastaj e transmetuar në **mediet tjera**³).

PJESA E PARË E SPINIT ndërlidhet me pyetjen: **Ku shkuan 92 miliona euro të Sorosit?**⁴ Dhe me spin - përgjigjen e dhënë menjëherë: duke marr parasysh se publiku nuk ka projekte konkrete, ose „**Rrejt joqeveritar dhe i medieve në vend të projekteve - Kush i „ngrëni“ parat e Sorosit?**“⁵.

Mënyra më e thjeshtë për de-spinim të pohimit të lartpërmendur është numërimi i të gjitha projekteve që ka përkrahur ose zbatuar Fondacioni dhe gjitha donacionet materiale për periudhën konkrete. Vetëm si shembull:

- **1993**⁶ - mes tjerash: plotësimi i fondit të bibliotekave në shkolla, pajisje për fakultetet (farmaci, elektro-teknikë, pylltari, mjekësi...), materiale dhe pajisje për spitale, pajisje për Akademinë e Shkencave, për muze, teatro ... Pjesa më e madhe e parave në këtë periudhë janë harxhuar për ndihmë humanitare dhe mjekësore
- **1994**⁷ - mes tjerash: kompjuterë për shkolla të

mesme, trajnime për mësimdhënësit, pajisje për mbrojtje të pasurive kombëtare, përkrahje për refugjatët nga Bosnja dhe Hercegovinës. Pajisje mjekësore ...

- **1996**⁸ - mes tjerash: ndihmë për fakultetet (libra, pajisje, financim i konferencave dhe vizita të ngjarjeve profesionale), përkrahje të bibliotekave, formimi i internet rrjetit të parë në universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, pajisje mjekësore dhe materiale për spitale
- (...)
- **2007**⁹ - mes tjerash: përmirësim të kushteve të jetesës së romëve, ruajtjen e trashëgimisë jetësore
- (...)
- **2009**¹⁰ - mes tjerash: vetëpunësimin e të rinjve, zhvillimin e mjediseve rurale, ndihmë për fermerët e vogël për ruajtjen e pronave familjare bujqësore (rajoni lindor dhe qendror i Maqedonisë), përkrahje për gratë në vendet rurale, përkrahje të artizanaleve në Berovë, ...
- (...)

Cekja e emrit të plotë të Fondacionit është pjesë me rëndësi të madhe në këtë por edhe në pjesët e ardhshme. Lidhja e Fondacionit me emrin Soros turbullon pasqyrën e veprimit të saj dhe mënyrën (burimet) e fitimit të mjeteve financiare më të cilat më tutje financohen projektet konkrete.

PJESA E DYTË E SPINIT ka të bëjë me aktivitetet e parapara dhe investimet e që mund të bëhen me këto para, ose: **Çfarë mundej të bëhet me paratë e FSHHM?**¹¹ Pjesa më e madhe e medieve që shpërndajnë spinin **theksojnë aktivite konkrete dhe investime konkrete**¹² ku **kanë mundur të përdoren paratë**¹³ e Fondacionit (për shembull: autostrada, ndërtimi i zonave teknologjike-industriale për zhvillim (ZTIZH), fabrika).

De-spinimi i kësaj pjese duhet bërë duke u thirrur në **Ligjin për shoqata dhe Fondacione**.

Sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione: E drejta për shoqërim të lirë realizohet nëpërmjet shoqërimit në shoqata, fondacione, asociacione dhe forma organizative të organizatave të huaja (në tekstin e mëtutjeshëm: organizata) **për realizimin e qëllimeve dhe veprimtarive të tyre, dhe mbrojtjen e të drejtave, interesave dhe besimeve në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin**. Organizatat janë të pavarura në drejtimin, përcaktimin dhe realizimin e qëllimeve të parapara me statutin e tyre në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Akti për themelimin të Fondacionit përmban qëllimet e Fondacionit. Me statutin rregullohen - qëllimet e Fondacionit dhe veprimtaria me të cilën realizohen qëllimet e Fondacionit.

{Parashtrohet pyetja me të cilën drejtë mediet përzihen në përcaktimin e lirë të qëllimeve dhe veprimtarisë së një fondacioni, nëse ata nuk janë të kundërta me ligjet dhe kushtetutën? Dhe me cilën të drejtë ata kërkojnë që Fondacioni të vepron në mënyrë të kundërt me aktin për themelimin dhe statutin që i ka fituar në mënyrë legjitime në Republikën e Maqedonisë? Vet përzierja dhe thirrja që Fondacioni të vepron jashtë akteve të miratuara, paraqet kërcënim dhe vështirësim i veprimit të fondacionit të formuar legalisht dhe duhet sanksionuar në mënyrë përkatëse.}

Organizatave nuk mund të themelohen për të pasur fitime.

{Nxitja e një organizate të tillë të investon mjetet financiare në mënyrë që paraqet realizimin e profitit, kurse hapja e fabrikave sipas definicionit paraqet një shembull të tillë, gjegjesisht kërkesa nga mediet që këto mjete të shpenzohen në aktivitete që nuk janë paraparë di qëllime të organizatës me statut dhe program, paraqet nxitje për thyerje të ligjeve, dhe si e tillë duhet sanksionuar.}

PJESA E TRETË E SPINIT ka të bëjë me vlerësimin e qëllimeve për të cilat janë shpenzuar pjesë e parave të Fondacionit. Në disa prej medieve shumë drejtpërdrejtë theksohet se bëhet fjalë për „**Miliona portale të pavlefshme thjeshtë të hedhura**“¹⁴.

De-spinimi duhet të zhvillohet nëpërmjet realizimit të të drejtave qytetare dhe politike dhe liritë themelore të garantuara me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë (dhe me këtë të pranuar si pjesë e legjislaturës kombëtare). Gjegjesisht, mohimi i dallueshmërisë (madje edhe partiake), ndërhyr në fushën e vegimit të pluralitetit si themel i demokracisë

PJESA E KATËRT E SPINIT është sigurisht edhe më e papërpunuar dhe më e lehtë për de-spinimi: **Soros në Maqedoni ka harxhuar 92 milionë euro, zero fitim për shtetin**¹⁵.

Në de-spinimin duhet theksuar projektet që paraqesin përkrahje dhe fitim për shtetin, dhe si të tilla janë ose të përkrahura nga shteti ose të pranuar si donacione, ose janë pjesë e marrëdhënies partnere me Fondacionin dhe shtetit. Vetëm si shembull:

- **2007**¹⁶ Iniciativa për shëndet mental që e ka zbatuar Ministria për punë dhe politika sociale. / Politikat për trajnim të nëpunësve shtetëror, projekt i zbatuar nga Agjencia për nëpunës shtetëror.
- **2009**¹⁷ Arsimi për të varfrit, projekt ku partner organizata është Ministria e arsimit dhe shkencës. / Reforma penale-ligjore, që zhvillohet në partneritet me Ministrinë e drejtësisë.

De-spinimi duhet të përfshin edhe elementin e pagesave. Gjegjesisht, gabohet shumë nëse deklarohet se shteti nuk ka fitime nga milionat e përmendura. Edhe nëse nuk i përfshijmë gjitha projektet bursat, trajnimet, kurset dhe investimet e drejtpërdrejta materiale, mbetet fakti se PËR SECILIN DENARË TË SHPENZUAR PAGUHEN PAGESAT PËRKATËSE PËR SHTETIN. Kjo është veçanërisht e

rëndësishme pasi që gati se pa përjashtim në vendet anëtare të BE-së jo vetëm që Fondacionet janë të liruara nga këto pagesa por mjetet e dhuruara shërbejnë si bazë për lirim nga tatimet! Me tatimin e këmbëngulës, Maqedonia futet në grupin e shteteve të udhëhequra nga Rusia.

PJESA E PESTË E SPINIT ka të bëjë me ndërtimin e përshtypjes se bëhet fjalë për uzurpimin e shtetit nga ndonjë entitet të jashtëm (sipas disa medieve **Maqedonia tani më 21 vite është e poseduar nga Soros**¹⁸).

De-spinimi duhet të tërheq vëmendjen kah mundësitë ligjore që shteti i ka si i përket entiteteve të jashtme, që i thyejnë ligjet dhe nuk e respektojnë

të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare. Domethënë, ose bëhet fjalë për shkelje të ligjeve (dhe kjo duhet proceduar dhe sanksionuar në mënyrë përkatëse), ose bëhet fjalë për shpifje (ose fajësim se dikush ka kryer ndonjë vepër penale pa mos pasur baza për një pohim të tillë).

PJESA E GJASHTË E SPINIT është diçka që gjithashtu kërkon de-spinim. Gjegjësisht, **financimi i organizatave joqeveritare ndërkombëtarisht të pranuar**¹⁹ si Human Rights Watch kurrsesi nuk mund të konsiderohet si komponentë negative nga pikëpamja e shpenzimit të parave në skenën më të gjerë (botërore), edhe përkaj konotacionit të dhënë në kontekst të tërë spin tekstit.

Kjo analizë është përpunuar në kuadër të Projektit i USAID për përforsim të medieve në Maqedoni - Komponenti **Shërbim për kontroll të fakteve nga mediet**²⁰, zbatuar nga Metamorfozis. Analiza është mundësuar me përkrahje të Agjencisë amerikane për zhvillim ndërkombëtar (AAZHN/USAID). Përmbajtja e analizës është përgjegjësi e autorit dhe nuk i pasqyron qëndrimet e Metamorfozis, USAID ose Qeverisë së SHBA-ve. Për më shumë informata mbi punën e USAID në Maqedoni ju lutemi vizitoni ueb-faqen (<http://macedonia.usaid.gov>) dhe Fejsbuk faqen e USAID-it (www.facebook.com/USAIDMacedonia).

LINQE:

1 <http://bit.ly/alarm18-1>

2 <http://bit.ly/alarm18-2>, botuar në Utrinski Vesnik, 14 shtator 2004, artikulli "Rampart versus Soros" i Arsim Zekollit

3 <http://bit.ly/alarm18-3>, botuar në www.libertas.mk, 15 shtator 2014

4 <http://bit.ly/alarm18-4>, botuar në www.kurir.mk, 10 shtator 2014

5 <http://bit.ly/alarm18-5>, botuar në www.vistina.mk, 10 shtator 2014

6 Porti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 1992-93 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-6>

7 Raporti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 1994 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-7>

8 Raporti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 1996 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-8>

9 Raporti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 2007 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-9>

10 Raporti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 2009 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-10>

11 <http://bit.ly/alarm18-4>, botuar në www.kurir.mk, 10 shtator 2014

12 <http://bit.ly/alarm18-12>, botuar në www.netpress.com.mk, 11 shtator 2014

13 <http://bit.ly/alarm18-13>, botuar në www.denesen.mk, 11 shtator 2014

14 <http://bit.ly/alarm18-14>, botuar në www.maxim.mk, 10 shtator 2014

15 <http://bit.ly/alarm18-12>, botuar në www.netpress.com.mk, 11 shtator 2014


16 Raporti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 2007 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-9>

17 Raporti vjetor i Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni për vitin 2009 në dispozicion në <http://bit.ly/alarm18-10>

18 <http://bit.ly/alarm18-18>, botuar në www.netpress.com.mk, 10 shtator 2014

19 <http://bit.ly/alarm18-18>, botuar në www.netpress.com.mk, 10 shtator 2014

20 www.proverkanafakti.mk



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN OTBORENO
SOCIETY OPICTESTVO
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА